



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së); dhe
- Aplikacionin e KEK-OSSH-së të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE7) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 22 mars 2013 nxori këtë:**

VENDIM

- I. **APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mbulohen nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes për periudhë rregullative 5 vjeçare duke filluar nga 1 prill 2013 deri më 31 mars 2017.

ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjetike e Kosovës SH.A. (KEK) aplikacionin e OSSH-së për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga OSSH-ja përmes ngarkesave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes(DUOS).
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga OSSH, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut i lëshuar me datën 19 tetor 2012;
 - Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes i publikuar me datën 8 janar 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë i publikuar me datën 22 shkurt 2013.



- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga OSSH-ja për periudhë rregullative 5 vjeçare duke filluar nga 1 prilli 2013 deri më 31 mars 2017 janë paraqitura në tabelën në vijim.

Vlerësimi përfundimtar i MAR për biznesin e licencuar të OSSH-së	2013 €m	2014 €m	2015 €m	2016 €m	2017 €m	Total €m
Gjithsej	70.19	67.93	67.72	66.05	65.84	337.73

- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH të paraqitura në tabelë do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore dhe zbatimit të Faktorit Profilizues, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes.
- IV. Mbajtësi i licencës për OSSH duhet t'i përgatis dhe dorëzoj për aprovim ZRRE-së ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes (DUOS) të përcaktuar me këtë Vendim, brenda një afati sa më të shkurt .
- V. Ngarkesat e propozuara nga OSSH duhet të jenë në përputhje me Parimet e Përcaktimit të ngarkesave në Shpërndarje të lëshuara nga ZRRE .
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- VII. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtar

Krenar Bujupi, Anëtar